


Kodi i Prespës

Histori për “rrugën e humbur”

Monografi





Kodi i Prespës

Histori për “rrugën e humbur”

Monografi

KODI I PRESPËS

Histori për “rrugën e humbur”

Monografi

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
përfaqësuar nga drejtoresha Dr. Neda Zdraveva

Redaktore:

Urani Pirovska

Drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Autor:

Borjan Jovanovski

Përkthimi në shqip:

Shenasi Jaji

Dizajni grafik dhe shtypi:

Relativ

Viti i botimit:

2022



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT



Projekti „Bashkëjetesa nuk është mit - mësim nga Prespa e Poshtme“ është pjesë e projektit „Rijeti i pajtimit REKOM“ financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

A decorative wavy line in a light gold color starts from the top left, curves down and to the right, then loops back down and to the left, ending near the bottom left of the page.

PËRMBAJTJE:

6 | Parathënie

13 | Kodi i Prespës

Parathënie

Vëllamëria – kulturë lidhjeje

Ljupço S. Risteski

Dorëshkrimi „Kodi i Prespës”, i cili përmban disa intervista që flasin për vëllamëritë ndërmjet individëve dhe familjeve me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare që janë ushqyer brez pas brezi në Prespë, dhe sot njihen si një vlerë e veçantë e kulturës së të jetuarit në zonë, janë vërtet “kodi specifik i Prespës”. Redaktori i botimit, gazetari Borjan Jovanovski, familja e të cilit e ka origjinën nga Prespa, e njohu vlerën e vëllamërisë si institucion shoqëror në jetën kulturore dhe historike të zonës, ndaj realizoi disa intervista me anëtarë të familjeve probatine për breza të tërë, me qëllim për të nxjerr në pah këtë dukuri si një nga shtyllat bazë të kulturës së edukimit të brezave të rinj me shembuj nga e kaluara dhe mënyra e jetesës së prespanëve si bazë për bashkëjetesë të mirë dhe respekt të ndërsjellë.

Vëllamëria si institucion shoqëror ka ekzistuar, ndoshta, sa ka ekzistuar njeriu, madje në antropologji është vërejtur në një numër të madh bashkësish tradicionale dhe arkaike në botë. Zakonisht, vëllamëria krijohet brenda bashkësive më të vogla dhe më të mbyllura, ku shtresimi shoqëror është ende i organizuar dhe i strukturuar në bazë të marrëdhënieve farefisnore. Mund të thuhet me siguri se institucioni shoqëror i *vëllamërisë*, në shoqëritë ku shtresimi shoqëror bazohet në marrëdhëniet dhe konceptet farefisnore, lidhet me *ndërvarësinë e ndërsjellë* të ndërveprimeve të individëve dhe bashkësive. Prandaj, termi *ndërvarësi* përfshin ndërveprime simbolike shoqërore „sy në sy”, në të cilat subjektet ndikojnë në njëri-tjetrin, duke komunikuar në mënyrë shumëpalëshe, dhe në këtë mënyrë duke përdorur pothuajse të gjitha njohuritë që lidhen me veprimet e ndërmarra. *Ndërvarësia e ndërsjellë ose thirrja ndaj njëri-tjetrit* gjithashtu i referohet marrëdhënieve shoqërore më të përhershme të bazuara në norma, rregulla dhe sanksione shoqërore ndërmjet pjesëmarrësve që përbushin role shoqërore në pozita të caktuara shoqërore. Disa nga këto ndërveprime mund të jenë intensive, dhe disa prej tyre janë më të formalizuara dhe kanë një kuptim të fortë simbolik (Slavjanskije drevnosti 2009: s.v. pobratimstvo, 79; Rečnik 2000: s.v. pobratimstvo, 320–322).

Koncepti i *ndërvarësisë* në antropologji është i përshtatshëm për të përshkruar jo vetëm përfshirjen e njerëzve në ndërveprime dhe lidhje shoqërore, por edhe për të përshkruar dhe analizuar të gjitha veprimet njerëzore që lidhen me kufizimin ose shmangien e mundshme të bashkëpunimit dhe ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore. Këtu dalin në plan të parë *kufijtë socialë dhe kulturorë* (Lubash 2021: 90–95).

Në kontekstin e shqyrtimit të ndërvarësive shoqërore, institucioni i vëllamërisë/motërzimit në etnologji dhe antropologji shihet si një mundësi për realizimin e ndërveprimeve ndërmjet aktorëve shoqërorë, natyrisht, në masën që kufijtë e caktuar simbolikë e lejojnë ose e justifikojnë atë.

Në Ballkan, vëllamëria dhe motërzimi ishin, dhe në disa rajone janë ende, një fenomen social që siguron, nëpërmjet lidhjes, njëfarë stabiliteti, paqe dhe siguri për komunitetet që jetojnë dhe ndajnë një hapësirë të përbashkët kulturore.

Në literaturën etnologjike dhe antropologjike, *vëllamëria* trajtohet si një nga institucionet shoqërore më domethënëse për hierarkizimin shoqëror dhe lidhjen farefisnore. *Vëllamëria* është një *kategori e farefisnisë shpirtërore rituale në rangun e farefisnisë së gjakut*, e cila si institucion shoqëror njihet shumë herët si kulturë e lidhjes, veçanërisht në kushtet e jetesës së bashkësive me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare, bashkësi ku ka mundësi për zhvillim të armiqësisë, padurimit reciprok ose mundësi për rivalitet të pabarabartë. Vëllamëria, në raste të tilla, përfaqëson një institucion të rregullt shoqëror, nëpërmjet të cilit individët, pastaj edhe familjet e tyre, dhe në një kontekst më të gjerë dhe gjenerata të tëra, sigurojnë stabilitet të mjaftueshëm të marrëdhënieve, respekt të ndërsjellë dhe, natyrisht, kultivimin e kulturës së fqinjësisë së mirë dhe bashkëjetesës. Krahas mundësisë së stabilitetit të marrëdhënieve ndërmjet individëve, familjeve dhe bashkësive vëllamëzore, *vëllamëria* ofron edhe baza reale për bashkim ndërmjet pjesëtarëve të ndryshëm nga etnia/feja, pa kaluar kufijtë që mund të prishin marrëdhëniet e themeluara ndërmjet njërit dhe tjetrit. Prandaj, shumë studiues të shoqërisë i kushtojnë një rol të rëndësishëm *vëllamërisë si një faktor koheziv në shoqëritë* në të cilat diversiteti mund të ketë gjithashtu një rol shpërbërës apo dezintegruës.

Fryma e vëllamërisë

Tradita e vëllamërisë në Ballkan është jetëgjatë dhe dëshmohet nga materialet e shkruara, por shumë më tepër etnografike dhe folklorike të ruajtura përmes formave të transmetimit gojor. Format rituale të vëllamërisë ishin të ndryshme, kryesisht shumë të thjeshta, por me simbolikë jashtëzakonisht të fortë. Shpesh, njerëzit që ishin në vëllamëri, shkëmbenin vetëm një grusht tokë, sepse toka kishte kuptimin më të madh për njerëzit, ajo është dhuruese e jetës. Toka, gjithashtu ka edhe simbolikën e betimit dhe fjalën e dhënë për të dy palët në vëllamëri.

Vëllamëria mund të bëhej edhe duke shkëmbyer kapelet e veta, por më së shpeshti bëhej me *përzierjen e gjakut*, ose më mirë me *pirjen e gjakut* („pubratime pu krŕ” – Tanoviç 1927: 277). Përzierja e gjakut bëhej nga vëllamët duke shpuar ose prerë dorën, duke thithur gjakun direkt në gojë dhe duke puthur njëri-tjetrin ose duke pirë (Tanoviç 1927: 276–277). Për shkak të përzierjes së gjakut, vëllamëria konsiderohej e barabartë në forcë dhe vlerë me *lidhjen familjare (të gjakut)*. Vëllamëria bëhej në vatër, në prag të shtëpisë, buzë lumit, në një vend të shenjtë (kishë, xhami) dhe në vende të tjera (Radul 2013: 32–36).

Vëllamëria dhe pajtimi

Vëllamëria pati një rol jashtëzakonisht domethënës në rastin e pajtimit mes dy familjeve “gjakatare”. Për të “pajtuar gjakun” organizohej *vëllamërimi (pirja e gjakut)* ndërmjet familjeve. Neni 140 i Kanunit të Lekë Dukagjinit parasheh:

„988. Pasi të qetësohen zemrat e shtëpisë së të vrarëve dhe shtëpisë së vrasësit, do të pinë gjakun e njëri-tjetrit.

989. Marrin dy gota të vogla, i mbushin përgjysmë me ujë ose me raki; një nga shokët ngrihet, i lidh dy gishtat e vegjël, i shpon me një gjilpërë, duke lënë të rrjedhë një pikë gjaku në dy gotat.

990. Pasi e përziejnë gjakun dhe e përziejnë mirë, shkëmbejnë gota dhe, duke kryqëzuar duart, pinë gjakun e njëri-tjetrit. - Të shoqëruar me mijëra urime, ata qëllojnë me armë dhe bëhen vëllezër të rinj si nga një baba dhe një nënë". (Kanuni i Lekë Dukagjinit 1994: neni. 140, fq. 188)

Vëllamëria, fatkeqësia dhe ndihma reciproke

Etnologjia përmend se një nga arsytet e vëllamësië është fatkeqësia. Në raste të kushteve të vështira socio-ekonomike dhe ushtarake, familjet shpesh gjendeshin në situata të ndryshme. Disa më keq, të tjerët pak më mirë. Solidariteti dhe ndihma në kushte të tilla do të thoshte shumë. Të tillë janë shembujt që përmenden si motive të binjakëzimit të familjeve Popovci nga Dolno Dupeni dhe Sherifi nga Nakolec.

"Motivi është para së gjithash solidariteti përballë fatkeqësisë. Për shembull, banorët e Nakolecit do të zhvendosen, një vendim i autoriteteve të atëhershme, sepse kërcënohen nga gjuajtja e artilerisë. Dhe pastaj lajmërohen familjet duke ju thënë: "Ejani te ne". Dhe këto marrëdhënie të mira ndoshta kanë ekzistuar më parë. /.../ Jo, por ata kanë ekzistuar më thellë në jetë siç i thonë nga respekti i ndërsjellë, miqësia dhe thjesht miqtë i ftojnë këtu..."

"Vëllamëria jonë, e familjes sonë Popovci, me familjen Sherifi nga Nakolec, është forcuar dhe konkretizuar deri në atë shkallë siç e shihni sot, si të themi, gjatë Luftës së Parë Botërore. Fshati Nakolec në Luftën e Parë Botërore u shpërngul kryesisht sepse ishte në trajektoren e përplasjes së artilerive mes dy palëve kundërshtarë. /.../ Në këtë kuptim, familja, pjesë e familjes së... Sherifi, mbi të gjitha familja e Shukri Sharifit me djemtë Beçën e Zaljon dhe vajzën Kadimen, janë të lidhura me familjen Popovci. Domethënë, familja Popovci është nikoqiri i tyre që i mirëpret në shtëpinë e tyre. Ata vendosen në shtëpinë e familjes Popovci dhe bashkëjetojnë 5 vjet me familjen Popovci. /.../ Që atëherë, ajo familje në veçanti ishte thelbi i një miqësie të madhe mes familjes Popovci dhe Sherifi në tërësi..."

Vëllamëria si institucion shoqëror nënkupton *detyrime* dhe *përgjegjësi* ndërmjet vëllamëve, bashkësive dhe familjeve në vëllamëri. Sipas të drejtës zakonore, vëllamët, si familjarë të afërt, janë të detyruar që në rast nevojë të ndihmojnë individët ose të gjithë familjen e vëllamëzuar. Raste të tilla janë vërejtur në bisedat për familjet vëllamëzore mes maqedonasve dhe shqiptarëve në Prespë.

“Sepse ne jemi të pakët në numër dhe ata janë të pakët. Le të themi se jeni në një qytet të madh, nuk mund të jeni, as me fqinjin tuaj - një fqinj. Por këtu jemi të detyruar, ke nevojë për të, ai ka nevojë për mua. Ma jep kaun, ma jep gomarin, unë ta jap samarin. Ishte një kohë varfërie. /.../ Po, ashtu ishte, varfëri, ndihmonin njëri-tjetrin. /.../ Dhe kjo të lidh, e di kur... kur do të më ndihmojë një herë, ti duhet ta ndihmosh në këmbim. Dhe kjo është normale dhe njerëzore”.

Vëllamëria dhe endogamia fetare dhe etnike


Në historinë e bashkëjetesës në territorin e Maqedonisë përgjithësisht praktikohet(j) parimi i *endogamisë* fetare dhe etnike. Kjo do të thotë se edhe pse ka shembuj të martesave ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme fetare apo etnike, ato nuk kanë qenë të shpeshta dhe as nuk janë konsideruar të pranueshme nga ana shoqërore. Mund të thuhet se endogamia fetare dhe etnike përfaqëson kufirin shoqëror që është vështirë të kalohet. Në shumë raste, *vëllamëria si institucion* e ka përkrahur dhe e ka caktuar një kufi të tillë dhe në këtë kuptim mund të thuhet se vëllamëria, aq sa lidh, aq edhe mban *kufijtë dhe distancën* e njërit nga tjetri. Vëllamëria ndalon mundësinë e martesës së mundshme të individëve nga të dyja palët, të cilët tashmë janë familjarë të afërt.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, pas “vëllamërimit që ndodh me *pirjen e gjakut, ndërmartesa* ndërmjet vëllamëve, shtëpive dhe vatrave të tyre është e *ndaluar përjetë*”. (Kanuni i Lekë Dukagjinit 1995: neni 103, fq. 150)

Nga materialet në terren dhe bisedat e botuara në libër, vërehet se *vëllamërim*it në Prespë ende i kushtohet një rëndësi e madhe. Para së gjithash, shihet si një traditë e vlefshme që ushqehet dhe mbështetet deri në ditët e sotme, megjithëse, të paktën nga materialet që disponojmë, nuk dihet nëse në Prespë krijohen vëllamëri të reja apo ruhen vetëm ato të vjetrat, vëllamëritë ekzistuese. Megjithatë, *vëllamëria*, së bashku me *kurbetllëkun* (*mërgim*), perceptohen si karakteristika specifike, rregullim shoqëror dhe kulturë jetese dhe si vlera të veçanta të Prespës. Ata janë *modus vivendi* i Prespës, pavarësisht se zona, si shumë të tjera, ka mbetur në margjina dhe pa njerëz prej dekadash. *Kurbetllëku* nuk është më mënyra e jetesës së Prespës, por shpërngulja (emigrimi). Emigrimi dhe globalizimi janë me shumë gjasa arsyet pse *vëllamërimi* nuk është më një doktrinë sociale aktuale e ruajtjes dhe mbështetjes së stabilitetit, solidaritetit dhe mirëqenies midis individëve dhe komuniteteve. Sot, nëse ka të tillë, janë të ndërlidhur dhe të varur nga faktorë dhe aktorë të tjerë socio-politikë, të cilët, pa marrë parasysh format tradicionale të hierarkizimit shoqëror dhe vendosjen e ekuilibrit dhe stabilitetit, përpiqen të importojnë forma "të reja" të multikulturalizmit dhe respektit reciprok.

Literatura

- » Antonij Dragomir. *Prilog proučavanju pobratimstva*. Glasnik Etnografskog instituta 26-28. Etnografski institut, SANU, Beograd, 1977, 43-57.
- » *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Përktheu nga shqipja Kim Mehmeti. Fi-ga – Tetovë, 1994, 1-266.
- » Lubash Marçin. *Raznoverci. Bashkëjetesa ndërfetare në një fshat në Maqedoninë Perëndimore. Një studim në fushën e antropologjisë sociokulturore*. Shoqëria Etnologjike Studentore Maqedonase - MSED, Shkup. 2021, 1-419.
- » Radul Andreevna Olga. *Pobratimstvo i posestrinstvo kak formy obščestvennogo vospitanija u vostočnyh slavjan VI-XIII vekov*. Ученые записки Петрозаводского государственного университета. Общественные и гуманитарные науки 1 (130): 32-36. <<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=188165>>
- » *Fjalori i mitologjisë popullore të maqedonasve*. Redaksia: Vrazhinovski Tanas, Zogoviç Sonja, Karaxhovski Vladimir, Jovanovska Sonja, Ristovska-Josifoska Biljana. Matica makedonska, Shkup 2000, s.v. vëllamëria, 320-321.
- » *Slavjanskije drevnosti: Etnolingvističeskij slovarʒ*. Vëllimi 4. P–S (Sito). Moskë: RAN, IS, 2009, s.v. vëllamëria, 79.
- » Tanoviç Stevan. *Srpski narodni obiçaji u Devdelijskoj Kazi*. SKA. Srpski etnografski zbornik, knj. 40, Život i obiçaji narodni, knj. 16. Beograd-Zemun, 1927, 1-483.

An abstract graphic on a solid yellow background. A thin, dark grey line starts at the top left, curves down and to the right, then loops back to the left, forming a large, open circle. The line continues to curve down and to the right, ending at the bottom right. The text "Kodi i Prespës" is positioned in the upper right quadrant of the image.

Kodi i Prespës

Prespën e njoh aq sa e njoh veten time. Sa herë që nisem drejt Prespës, kur arrij në fshatin Slivnicë, ku fillon e ashtuquajtura Prespa e Poshtme, me kënaqësi lëshohem drejt asaj bukurie unike që në shfaqjet e mia përkufizohet si shkretëtirë e zbutur. Shkretëtirë sepse shtrihet në rrëzë të Malit Baba dhe Galiçica dhe si e tillë është lënë apo thënë më mirë e harruar, për mirë apo për keq, nga regjimi kaotik institucional i shtetit të cilit i përket. Kurse e zbutur... e zbutur sepse e kujtoj dhe e jetoj në një atmosferë paqeje dhe një qetësie të theksuar mistike.

Nuk është rastësi që në këtë trevë ka shtresa artefaktesh të renditura kronologjikisht njëra mbi tjetrën si dëshmi e një dinamike të jashtëzakonshme qytetëruese nga lashtësia e deri më sot, të cilat janë dëshmi e pranisë dhe bashkëjetesës së kulturave të ndryshme.

Vetëm në disa fshatra me jo më shumë se 500 banorë, që janë popullsia e fundit e gjallë duke marrë parasysh migrimin masiv për shkak të kushteve jashtëzakonisht të pafavorshme socio-ekonomike, do të gjeni maqedonas, shqiptarë, turq dhe romë. Të gjithë me një pemë familjare, rrënjët e së cilës janë thellë në Prespë ndër shekuj. Klarinetisti Nazmi është rom, ka një shekull që jeton. Së bashku me Zizon dhe Zaimin, si orkestër kanë një repertor të madh me këngë maqedonase, shqiptare, turke dhe rome me të cilat kanë luajtur në të gjitha dasmat dhe festat e fshatrat në të kaluarën. Kur e takova Nazmiun gjallë e mirë në moshën 100-vjeçare, duke treguar për të kaluarën dhe origjinën e tij prespane, kujton se gjyshi i tij, i lindur në fshatin Nakolec, vdiq saktësisht në moshën 100-vjeçare, kur Nazmiu ishte shumë i ri. Nazmiu është një dëshmi e gjallë e pranisë së komunitetit rom në Prespë prej të paktën 3 shekujsh. Prania e maqedonasve, shqiptarëve dhe turqve, të krishterëve dhe myslimanëve, flet për artefaktet e mesjetës, të cilat u lanë në mëshirë të natyrës, të harruara nga institucionet.



Për t'iu kthyer të kuptuarit tim për Prespën si një egërsirë e zbutur. Ja ku jam, 56 vjet jetoj paralelisht në Prespë dhe Shkup. Në vitet 1980, ndërhyrja e nacionalizmit agresiv të Millosheviçit në Maqedoni dhe shfaqja e një retorike të shëmtuar antishqiptare dhe islamofobike që përfshiu shpejt kryeqytetin më lanë në konfuzion. Shkupi u mbush me urrejtje, ndërsa Prespa ishte sikur të mos ishte nga këtu... e qetë dhe paqësore si gjithmonë. Maqedonasit, shqiptarët... jetojnë në paqe dhe të bashkuar. Së bashku në dasma, varrime, festime... Bashkëmoshatarët e mi maqedonas flasin shqip, shqiptarët, nga ana tjetër maqedonisht në lavdinë e plotë të atij dialekti që është në rrënjë të gjuhës letrare maqedonase. Në këtë kuptim, kam jetuar në dy botë paralele. Koha kaloi dhe në historinë e re ndodhën shumë ngjarje që derdhën shumë gjak në Ballkan në atë përplasje nacionalizmash primitivë. Lufta në Bosnje, pastaj ajo në Kosovë, pastaj në vitin 2001 në vendin tonë. Të gjitha këto episode të përgjakshme u hodhën poshtë nga Prespa sikur të ishte e mbrojtur hermetikisht nën një zile xhami. Në zhurmën e tmerrshme dhe shurdhuese të armëve në mbarë Ballkanin, në Prespë nuk u tha asnjë fjalë e keqe për njëri-tjetrin. Gjithçka vazhdoi si duhej, në mënyrë paqësore dhe të qetë, në një jetë të rregulluar nga ndonjë marrëveshje e pashkruar ose e nënshkruar e Ohrit që të gjithë e respektojnë pa kushte, duke ruajtur me kujdes thelbin e saj si diçka të shenjtë.

Si gazetar i kam përcjellë të gjitha ngjarjet e rëndësishme në zhvillimin e pavarësisë së Maqedonisë, në të cilat një nga episodet kyçe është Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila edhe pas 20 vitesh nga nënshkrimi i saj, nga një pjesë e madhe e shoqërisë maqedonase perceptohet si diçka e imponuar nga jashtë, si diçka e huaj, si një trup i huaj që duhet hedhur jashtë. Fjala vjen, një nga autorët e asaj marrëveshjeje është profesori Vlado Popovski, i lindur në fshatin Dolno Dupeni. Në një bisedë të gjatë me të, si mes dy prespanëve, folëm për atë rezistencë të panatyrshme ndaj normave të Marrëveshjes së Ohrit që rregullojnë bashkëjetesën e diversiteteve në Maqedoni. Siç e di në heshtje dhe qetësi profesori me njohuritë e tij të mëdha të historisë dhe përvojën e tij jetësore të Prespës, ai më shpjegoi kështu:

“Përkufizimet se është imponuar, se ka rënë nga qielli dhe se nuk ka të bëjë me vazhdimësinë e historisë dhe mendimit juridik dhe kushtetutave maqedonase, janë krejtësisht të pasakta. Fatkeqësisht, edhe kolegu im Svetomir Shkariq përmendi një përkufizim se ai është imponuar nga SHBA, por kjo është larg së vërtetës. Marrëveshja e Ohrit është kthim në rrugën e harruar të luftës së maqedonasve për shtetin e tyre dhe në këtë kuptim është korrigjim i rrugës së lënë pas dore të zhvillimit të shtetit maqedonas. Termi i parë i referohet luftës së maqedonasve për shtetin e tyre deri në Luftën e Dytë Botërore, kur ata nuk kishin shtetin e tyre, dhe termi i dytë i referohet zhvillimit të shtetit maqedonas nga viti 1944 deri në vitin 1991. Argumentin për pretendimin e parë, gjatë shekullit të 19-të, e bëri gjenerata e parë që ngriti çështjen e Maqedonisë si njësi e veçantë politike në Ballkan. Ajo gjeneratë e inkorporoi konceptin e Marrëveshjes së Ohrit në idenë e krijimit të shtetit maqedonas. Bëhet fjalë për Lidhjen Maqedonase të vitit 1880 dhe Kushtetutën e saj, Kushtetutën për rregullimin e ardhshëm kushtetues të shtetit maqedonas e miratuar nga Lidhja Maqedonase në vitin 1880. Është një akt i paraqitur në Komisionin Evropian pas Traktatit të Berlinit dhe i legjitimuar në bazë të nenit 23 të atij traktati, që të gjitha ato që nuk marrin një zgjidhje të veçantë do të reformohen si zona vetëqeverisëse brenda Perandorisë Turke, në përputhje me Statutin e Kretës të vitit 1868. Ajo kushtetutë parapëlqente krijimin e barazisë, politike dhe juridike, të të gjithë popujve që jetonin në një krahinë. Në këtë kuptim, që nga ekzistenca e saj, Maqedonia ka qenë gjithmonë një shoqëri multietnike dhe kurrë nuk ka qenë monoetnike. Brezi maqedonas

ishte i vetëdijshëm për faktin se në Maqedoni jetojnë sllavët maqedonasit sllavë, shqiptarët, se jetojnë vllah-cincarë, se jeton një komunitet më i vogël grekësh, se jetojnë turqit, se ata popuj jetojnë të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe e konceptojnë shtetin maqedonas si të përbashkët, jo vetëm si atdhe dhe shoqëri por edhe si shtet i përbashkët. Sipas asaj Kushtetute që Lidhja maqedonase i ofroi Komisionit Evropian, sipas numrit të grupeve të ndryshme, ishte paraparë se sa deputetë do të kishte në kuvendin kombëtar, një ndarje ministrish, një kryesi e përbashkët kolektive e kryesuar nga një përfaqësues i komunitetit shumicë, por do të kishte edhe përfaqësues nga të gjitha komunitetet në atë kryesi si organ suprem shtetëror. Gjithashtu parashikohet që shteti të garantojë barazi për të gjithë individët pavarësisht nga origjina e tyre. Në sferën e interesave të veçanta kombëtare - gjuhës dhe fesë, do të respektojnë vendimet e të ashtuquajturave komuna dhe organe kishtarë, dhe në këtë kuptim, kur duhet të miratohet një ligj që zgjidh këto të drejta kolektive, nuk ka parim mbivotimi, dhe nëse dikush mbivotohet, atëherë instituti kolektiv presidencial vendos më në fund për këto çështje. Në këtë kuptim, në vitin 1988 u formua kuvendi kombëtar dhe qeveria. Në atë qeveri ka maqedonas dhe shqiptarë. Në kuvendin kombëtar ka maqedonas, shqiptarë, vllahë, grekë etj. sipas pranisë së tyre. Ajo Kushtetutë, për fat të keq, nuk u pranua, dhe lëvizja maqedonase u mposht, por gjenerata e parë e la atë dokument si nënshkrim të profilit të shtetit maqedonas, që rrjedh natyrshëm nga profili i shoqërisë. Prandaj lirisht thuhet se Marrëveshja e Ohrit është kthim në rrugën e harruar”¹


¹ <https://novatv.mk/intervju-so-profesor-vlado-popovski-ohridskiot-dogovor-e-vrakane-na-zaboraveniot-pat-na-makedonskata-drzhavnost/>



Profesor Vlado Popovski

“Ruga e harruar” ishte një përkufizim që ngjalli kureshtjen për të kërkuar përbërësit e asaj substance të harruar maqedonase. Familja e profesorit, Popovci nga Dolno Dupeni, është vetëm një nga ata që kanë ushqyer vëllamërinë nga kohët e lashta e deri më sot. Anëtarët e familjes Popovci janë vëllamë me anëtarët e familjes Sherifi nga Nakoleci.

“Vëllamëria jonë, e familjes sonë Popovski, me familjen Sherifi nga Nakoleci, është forcuar dhe konkretizuar deri në atë shkallë siç e shihni sot, si të themi, gjatë Luftës së Parë Botërore. Fshati Nakolec në Luftën e Parë Botërore u shpërngul kryesisht sepse ishte në trajektoren e përplasjes së artillerive mes dy palëve kundërshtarë. Pra, nuk dihej nëse predhat do të binin aty ku ishin menduar apo do të binin në rrugë, në varësi të ngarkesës, dhe do të shkaktonin dëme të mëdha. Në këtë kup-tim, familja, pjesë e familjes së... Sherifi, mbi të gjitha familja e Shukri Sharifit me djemtë Beçën e Zaljon dhe vajzën Kadimen, janë të lidhura me familjen Popovski. Domethënë, familja Popovci është nikoqiri i tyre që i mirëpret në shtëpinë e tyre. Ata vendosen në shtëpinë e familjes Popovski dhe bashkëjetojnë 5 vjet me familjen Popovski. Nga Popovski janë ndarë disa ara për të prodhuar prodhimet e veta bujqësore: misër, kunguj, drithë etj. Bagëtinë e kullosin fëmijët e njëres dhe tjetres, dhe këtu, pas rrëfimit të Zaljos, që është pak më i madh se unë, më tha se 5 vjet kanë jetuar bashkë, janë rritur me fëmijët e Popovski. Që atëherë, ajo familje në veçanti ishte thelbi i një miqësie të madhe mes familjes Popovski dhe Sherifi në tërësi”, tregon profesori Vlado Popovski për vëllamërinë e familjeve Popovski dhe Sherifi. Respekti që anëtarët e këtyre dy familjeve kanë për njëri-tjetrin edhe sot e kësaj dite është i vështirë për t’u përshkruar... ajo marrëdhënie thellësisht njerëzore duhet të përjetohet në atë lëngun e vetëm njerëzor që ndihet në bisedën e tyre reciproke.”



Përndryshe, profesor Popovski dokumentoi episode të rëndësishme të marrëdhënieve maqedonase-shqiptare nga fundi i shekullit 19-të dhe fillimi i shekullit të 20-të, të cilat, për fat të keq, janë pak të njohura në sistemin arsimor maqedonas. Popovski është autor i librit “Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1830-1912)”.

“Në krizën lindore, kur ushtria turke ishte në ofensivë, Lidhja Shqiptare dha urdhër që të mos merreshin pjesë në fushatat ushtarake kundër maqedonasve që kishin ngritur kryengritje; Kryengritja e Rázllovecit zgjati pak, megjithatë, Kryengritja e Kresnenit nga 5 tetori 1878 deri më 2 maj 1879 zgjati më shumë se kryengritja e Ilindenit. Ajo mbulonte 36 rrethe. Urdhri i Lidhjes Shqiptare është që të mos marrin pjesë kundër kryengritësve. Dhe më vonë do të ketë marrëveshje të përbashkëta mes tyre. Kjo është shtjelluar në punimin e Katerina Todorovska, albanologe, e cila konkretisht hulumton çështjen e marrëdhënieve maqedono-shqiptare”, na rrëfen Vlado Popovski në bisedën tonë disa orëshe, në të cilën ka shumë detaje të tjera që flasin për atë që ai definon me saktësi e jashtëzakonshme si “rruga e harruar”.

Vëllamëria mes Zdravkos dhe Malikut

Në kërkim të gjurmëve të “Rrugës së harruar” të treguar nga profesori, arrita te Zdravko Xhajkovski dhe Malik Alimi, i pari nga fshati Lubojno, i dyti nga fshati Nakolec. I gjeta të ulur së bashku duke shijuar një raki të re në oborrin e Zdravkos, me pamje nga liqeni i Prespës. “Ku jeni vëllamë?” i thirra, dhe ata u çuditën nga fakti se nga e kisha marrë atë informacion për vëllamërinë e tyre. U tregova historinë përse kam ardhur dhe biseda filloi shpejt.

Malik: familjet tona janë në vëllamëri qysh në kohën e turkut. Gjenerata e katërt-pestë, mund të them. Dhe... unë dhe vëllamë ende e mbajmë këtë traditë.

Zdravko: Dhe do ta ruajmë edhe në të ardhmen.

MALIK: Po, do ta ruajmë.

Zdravko: Do ta ruajmë si njerëz... si njerëz normal, si ndryshe...!

Vëllamëria e tyre ka filluar shumë kohë më parë dhe ata thonë se janë brezi i katërt i vëllamërisë. Vëllamërinë e kanë nisur stërgjyshërit e tyre dhe ajo marrëdhënie e tyre ka një rol vendimtar për fshatrat e Prespës të cilat kjo vëllamëri i ka shpëtuar nga djegia.



Zdravko Xhajkovski

Malik: Gjyshi im e thoshte. Gjyshi i tij ka qenë oficer në ushtrinë turke. Kazermat ishin në Nakolec në atë kohë. Edhe Nakoleci ishte komunë. Dhe këta kanë qenë shokë, vëllamë, para se të ndodhte ngjarja, vrasja e Bimbashit në Lubojno. Dhe pastaj ushtria alarmohet dhe mbledhin njerëzit e fshatrave përreth këtu në fushë për t'i pushkatuar të gjithë. Për të djegur fshatrat. Dhe pastaj është ngritur gjyshi im, quhej Alim, ishte kolonel në ushtrinë turke atëkohë. Dhe i thoshte gjeneralit “Prit”, thoshte “mos u ngut”, thoshte “nuk e dimë nëse ata që vranë bimbashin janë nga këtu”... Nuk mund t'i marrim të gjithë në qafë për asgjë, ata vendosën të... Të djegin fshatrat. Dhe për të pushkatuar të gjithë njerëzit, ky ishte vendimi i tyre. Dhe ky gjyshi, gjyshi i

Zdravkos, e thërret gjyshin tim Alimin: "Vëllamë, s'kemi fajin ne", thoshte ai, "çfarë po ndodh këtu". Dhe i thoshte gjeneralit "Ndal...", Dhe i shpëtoi fshatrat Brajçino dhe Lubojno nga djegia.

Kur turqit u larguan, serbët erdhën në fshatra. Një qeveri e re që likuidonte të gjithë ata që ishin pranë osmanëve.

Malik: Stërgjyshi im Alimi e ka marrë gjyshin e tij, e kanë fshehur në Brajçino për dy javë.

MALIK: Ashtu ishte?

Zdravko: Po, po.

MALIK: Te ata në shtëpi.

Zdravko: E kanë fshehur sepse ...

Duhej ta vrisnin gjyshin e tyre.

BORJAN: Kush ta vriste?

MALIK: Serbët që erdhën.

Zdravko: Serbët që erdhën pas tyre.

MALIK: E kërkonin Alimin.

MALIK: Dhe ata e fshehën.

Zdravko: Dhe e çuan në shtëpi dhe e mbajtën, si familje, si gjak, si i tyre.



Malik Alimi

Që atëherë, ajo vëllamëri është përcjellë brez pas brezi. Maliku kujton fjalët e nënës dhe babait të tij tashmë të ndjerë.

Malik: "E thonin edhe babai edhe nëna ime. Ju duhet ta keni atë familje si familjen tuaj, si pjesë e shtëpisë suaj, si familje. Ata vazhdimisht e thonin këtë.

Dhe tani është si një pjesë e shtëpisë sime, një pjesë e familjes sime. Se... Si... Nuk di si t'ju them." Thotë Maliku, ndërsa Zdravko shton:

"Diçka e bukur në shpirtin tënd është kur ke një mik të vjetër, është mirë në shpirt. -Kjo është me gjenerata, kjo është ruajtur me gjenerata"

Zdravko: Babai më ka treguar për gjyshin e tij Vekon. Më kupton? Dhe kështu...

BORJAN: Dhe ua kanë lënë si amanet?

XHAJKO: Kur dikush në shtëpi të thotë fjalë të mira, do të dëgjosh mirë, do të kuptosh mirë dhe do të sillesh mirë dhe me respekt... e kupton si...?

Biseda jonë vazhdoi me kujtimet e Zdravkos dhe Malikut se si e ndihmonin njëri-tjetrin.

MALIK: Ne nuk ndajmë asgjë. Epo, në Nakolec, qoftë dasmë apo varrim, në të mirë e në të keq, shkojmë të gjithë. Zoti na ruajt, nëse ndodh diçka, është djegur një hambar, dikujt i është djegur shtëpia. Të gjithë ngrihen për të ndihmuar

Zdravko: Të gjithë do të ndihmojnë.

MALIK: ...në ndihmë.

MALIK: Ne e kemi rinovuar xhaminë para 25 vitesh, ndoshta para 30 vitesh, çdo maqedonas ka ardhur me makinë...

Zdravko: Unë e kam bërë instalimin, rrymën...

MALIK: -E. Erdhi një karrocë me gurë, ose rërë, ose... Kisha e Shën Nikollës që gjendet më poshtë, ishte gati të shembet...

Zdravko: Xhaxhai yt e bëri.

MALIK: Po, xhaxhai im Lako...

Zdravko: Ai ishte organizatori.

MALIK: Ai organizoi dhe mbledhi para në Amerikë, e rinovoi, nuk e di a keni qenë...

Zdravko: e di BORJANI ku gjendet kisha e Shën Nikollës.

Më tej, pashmangshmërisht arritëm në episodin e vitit 2001, kur në Maqedoni ndodhën ato përleshje ushtarake që kërcënonin të gjithë territorin e vendit. Prespa, më kujtohet gjithashtu, nuk ka pasur asnjë episod që do të prishte harmoninë e bashkëjetesës. Pyeta edhe Malikun dhe Zdravkon, të cilët e dinë akoma më mirë se unë, sepse janë banorë të atyre fshatrave.

Zdravko: Te ne nuk ka munguar asnjë pulë. E jo më njeri...

MALIK: ne nuk kemi parë asnjë fyerje, asnjë sherr...

Zdravko: Mëkat nga Zoti... Është mëkat nga Zoti të thuash se dikush i bëri diçka dikujt ose i tha diçka.

MALIK: Epo, kjo është bashkëjetesa që e thatë më parë.

XHAJKO: Edhe kultura poashtu. Mentaliteti ynë është pak më ndryshe. Pak më shumë - shumë më e butë, shumë më e avancuar.

MALIK: Kjo është arsyeja pse ne jemi krenarë për bashkëjetesën që kemi këtu.

Më intrigoj vetë-lavdërimi i Zdravkos se janë, siç thotë ai, "më të butë" ndaj pyeta se çfarë i dallon nga të tjerët. Dhe Maliku dukej se më priste me pyetjen.

Malik: Prespanët, qofshin shqiptarë apo maqedonas, kanë filluar të shkojnë në kurbet 200 vjet më parë.

Zdravko: Në vitin 1936 gjyshi im Trajko kishte ardhur me „ford“, erdhi, në Brajçino, me „ford“. Rruga është bërë për të, e kupton? Kudo rruga është bërë poshtë te ura... për të vozitur Ford-in.

MALIK: Edhe diçka tjetër ka bërë.

MALIK: Le të jetë kjo më e qytetëruar..... më e afërt mes njerëzve...

Zdravko: Epo, është ndryshe kur shikon botën.

MALIK: Sepse në Amerikë keni njerëz nga e gjithë bota, fqinji juaj mund të jetë nga Kina, nga Afganistani, nga Pakistani, nuk e dini nga ku mun ta keni. Dhe ju duhet të jetoni me fqinjin tuaj. Këtu në Amerikë kur jetonim, fqinjët tanë më të afërt ishin italianët, nga ana tjetër ishin gjermanët, dhe kështu bëhesh i afërt me ta, nuk e sheh se kush çfarë është. Edhe këtu ka diçka... logjikë, por kjo është e vërtetë, se prespanët, po të them unë...Sjellën me to një kulturë tjetër.

Dhe kështu nga njëri histori në tjetrën, koha kaloi dhe u errësua oborri i Zdravkos. I erdhi radha edhe temës së njohjes së gjuhëve dhe u magjepsa me faktin se shumë maqedonas dhe në mesin e tyre shumë fëmijë flasin gjuhën shqipe, ndërsa në Shkup e ashtuquajtura skenë politike nuk ka guxim as të hapë temën mbi nevojën që fëmijët maqedonas të mësojnë të paktën fakultativisht gjuhën shqipe në mënyrë që të jenë më afër bashkëqytetarëve të tyre etnikë shqiptarë.

MALIK: Në Nakolec të gjithë maqedonasit flasin shqip...

Zdravko: Shumica flasin, më bukur se ai. Ky harroi shqipen.

MALIK: Po të thërrisja sot vëllamë tim Canen, shqip me të, nuk e heton dot. Jo vetëm Cane, por të gjithë.

Zdravko: Të gjithë, të themi Vasil...

MALIK: Gjithkush, të gjithë.

Zdravko: Të gjithë, ja këto Purdevci, deri te i fundit.

MALIK: Te ne, të gjithë e flasin shqipen.

Zdravko: Ata u rritën së bashku.

MALIK: Jemi rritur bashkë.

Para përfundimit të kësaj gostie të gjatë në oborrin e Zdravkos, pashmangshëm filluam të flasim për politikë, siç është rendi këtu, apo te ne... Me shaka, por shumë i rëndësishëm për historinë time, Zdravko, përndryshe simpatizant i zëshëm i një partie më thotë "kjo vëllamëri është edhe në politikë"

Zdravko: Më erdhi vëllamë im dhe mu lut, unë votova, për hir të tij...

MALIK: Po, ashtu është.. e binda.

Zdravko: Çfarë, më binde? Unë e pashë atë si diellin në shtëpi.

MALIK: Erdha me Canën.

Zdravko: Më erdhi në shtëpi dhe... Nuk mund t'i thoja jo.

MALIK: Unë i thosha Canes „Le të shkojmë në shtëpi te Xhajko, vëllamë“. „A, jo“, thoshte „nuk ka fajde“, thoshte „ai meqysh në vitin '91“. „Le të shkojmë“, thash „hyr në makinë me mua “. Erdhëm, vjeshtë ishte, kishte punëtorë që mblidhnin molla këtu. Ashtu ishte?

Zdravko: Po, kisha...

MALIK: Dhe u futëm në oborr. „E“, bërtiti „vëllamë, mire se erdhe“. „Mirë se të gjeta“. Dhe hymë me Canen. Na ofroi kafe, raki, këtu jashtë u ulëm. Dhe i thash „Vëllamë, unë erdha të të lus diçka“. „E di“, tha. E di, sapo pashë Canen, sepse Cane është nga të tjerët. „E di pse ke ardhur“, më tha. Dhe i thotë pastaj Canes... Si i the?

Zdravko: Si? Trego ti. Trego lirisht.

MALIK: I thotë „ Unë do t'ju largoja, por këtë nuk mundem“, tha.

Zdravko: Ti je familja ime, ai është miku im. Ne jemi rritur me të, ai është familja ime, "jo", nuk mund t'i them jo. Epo, çfarë të bëjmë...


MALIK: Kjo ishte biseda, është e vërtetë.

Dhe kështu me Zdravkon, i njohur si Xhajko, dhe me Malikun, shkuam me makinë në të njëjtin vend dhe mbrapa. Një pasdite e bukur, nga e cila po ju përcjell vetëm një pjesë të vogël të episodeve të shumta të kësaj gostie të paharrueshme.

Vëllamëria mes Gëzimit dhe Borisit

Prespa është diçka si një muze i madh në hapësirë të hapur në një zonë të madhe dhe të gjerë që strehon artefaktet e periudhave të ndryshme, secila me dramën e vet. Mbaj mend që në shtëpinë e gjyshit hasja shpesh tela të vjetër dhe pjesë të radiostacioneve ushtarake, copa granatash (i mbaj lapsat dhe stilolapsat në një nga ato strofkat) dhe grumbuj sendesh të tjera që babai im i kishte grumbulluar nëpër mal si fëmijë. Radio nga ushtria franceze, një granatë nga ushtria serbe, disa kuti nga ushtria italiane dhe për të mos i renditur... në çdo shtëpi të Prespës ka gjësende të ndryshme që dëshmojnë për praninë e ushtrive të shumta që luftuan ose kaluan nëpër zonë. Si kanë shkuar disa e të tjerë kanë ardhur, të gjithë e kishin të preferuarin e tyre në pjesë të popullsisë vendase, qofshin maqedonas, shqiptarë, turq apo romë. Të gjithë janë përpjekur për heterogjenitetin e strukturës etnike të Prespës në kuptimin e maksimës së njohur "përçaj dhe sundo". Por nëse diku këto taktika kanë rezultuar të suksesshme, sigurisht që nuk është rasti me Prespën.

Kur bullgarët erdhën në këtë zonë, për shembull, kishte tendenca për ta paraqitur popullsinë shqiptare si armiqësore dhe për ta vënë në antagonizëm me maqedonasit. Dhe në vend të efektit të pritshëm të strategjisë bullgare, popullsia vendase kishte reaguar duke forcuar vëllamëritë. Kështu ndodhi me Borisin dhe Gëzimin. Njëri nga Dolno Dupeni, tjetri nga Nakoleci.



BORIS: Vëllamëria filloi nga gjyshi im, quhej Pavle dhe nga gjyshi i Gëzimit, Nefiu. Dhe vazhdoi të zhvillohet më pas... Vëllamëria filloi në kohën e bullgarëve, sepse në Dolno Dupeni erdhën shumë familje nga Nakoleci, u fshehën nga bullgarët. Dhe gjyshi i Gëzimit, Nefiu, kishte dy fëmijë, Mediun dhe Xhemalin. Xhemal quhej apo?

GËZIM: Xhema, po, Xhemal.

BORIS: Dhe ata ishin të vegjël, kurse Nefiu... gruaja e tij kishte vdekur për xhaxhain Nefi. Dhe këtu ata u ulën pesë deri në gjashtëmbëdhjetë ditë me ne dhe pastaj u kthyen në Nakolec. BORJAN: Por, pse kanë ardhur? Kanë ikur?

BORIS: Fshiheshin nga bullgarët.

GËZIM: Ka qenë një fazë në Nakolec, një moment kur spiuni kishte thënë diçka, ka qenë një grup nga Nakoleci dhe Krani. Bullgarët në... nuk e di, në një çfarë mënyre i akuzonin për një vepër që kishte ndodhur ... dhe merrnin, shkonin nëpër shtëpi, kërkonin grurë dhe gjësende, por edhe njerëz rrahnin...vritnin.

Dhe natyrshëm, familjet që kishin mundësi të... iknin, fshiheshin diku, gjyshi erdhi këtu te xha Pavle, babai i BORIS-it.

Ishin miq të mirë, vëllamë, por pas kësaj u bë vëllamëria, kështu që... Pra, gjak për gjak, si thuhej, kështu? Dhe të respektojmë njëri-tjetrin, pra miq të shtëpisë, që nga gjyshi im, gjyshi i tij. Pra, shtëpia e parë ishte këtu që u përmend... Qoftë për dasmë, për këtë, për atë, kështu... Për këtë shtëpi është folur, e pastaj për tezet dhe të afërmit e tjerë në Nakolec. Ata këtu ishin sikur familjarë të afërt me ne.



Gzim Sulejmani

Në vitin 2001 ndodhi një konflikt i armatosur, i cili ndër të tjera e vuri në provë këtë vëllamëri. Boris në bisedën tonë kujtoi një episod ose një bisedë që kishte ndodhur mes vëllamëve.

BORIS: 2001? Babai i Gëzimit më thoshte kështu, "BORIS, po të bëhej luftë dhe të përhapej këtu në Prespë, do më gjuaje mua?" "Jo det, ku të të gjuaj", i thashë, "ty të gjuaj?" "Nuk qëlloj dot", tha ai, "nuk do to qëlloj nëse edhe më vret". Dhe prandaj tha, nuk mund të fillojë luftë këtu, sepse asnjë shqiptar nga Nakoleci nuk qëllon në maqedonas, dhe asnjë maqedonas nga Dupeni, në ndonjë banor të Nakolecit. Dhe kjo është arsyeja pse është e pamundur që të vijë lufta këtu.



Boris Jovanovski

Dhe kështu kaloi viti 2001 traumatik në Prespë, pa u thënë asnjë fjalë që do të kujtohej keq apo do të kërcënonte në çfarëdo mënyre harmoninë e bashkëjetesës e cila tashmë është pjesë e asaj kulture vendase dhe identitetit të Prespës që ndër shekuj kanë kaluar shumë provokime. E lënë në vetvete, kjo traditë dhe kulturë përmban substancën magjike për suksesin e multikulturalizmit, i cili si vlerë qytetëruese është kudo në botë dhe i ekspozuar ndaj sulmeve të nacionalizmave dhe populizmit.

Fatkeqësisht, kjo kulturë në Prespë, bashkë me ujin në liqen, po largohet dalëngadalë bashkë me të gjitha kodet e pashkruara në të cilat fshihet receta për të ardhmen jo vetëm të Maqedonisë, por edhe të gjithë Ballkanit në shkëlqimin e saj multikulturor.

